



Social
Inclusion
For
Development



FEBRUARY 2024

RAPORTI VJETOR 2023

Social Inclusion for Development

sifd1879@gmail.com / Lezhë, Shqipëri

Trajnimin me temë “Shkrimi i një Koncept Note.

“Contact Making Seminar”

Dita e Karrierës

Ekspozitë “N’Shesh T’Burrave Pa Burrni”

“ESC Buddy Support System”

Different-Together-Strong, Interreligious and interconvictional dialogue from a woman’s perspective’

“TOSCA Training”

Paqja dhe Sporti

Youth Leader Workshop on Advocacy & Partnership Building.

Takim me Vullnetarët e Korpusit të Paqes.

Dialogu Rinor – Ndërthurja e Ideve dhe Energjisë Rinore për Një Ndryshim Pozitiv në komunitet”

Projekti “Vozisim N’Drin”

Projekti “Unë, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak”

Projekti “Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014”.

Rinia N’ Festë

Stafi i 2023

Statistika 2023

Fund



***“Ne besojmë në atë
çfarë bëjmë”***



AKTIVITETE

Trajnimin me temë “Shkrimi i një Koncept Note.



Organizata “Social Inclusion for Development” në bashkëpunim me “Youth Lead Lezhë” ka zhvilluar trajnimin me temë “Shkrimi i një Koncept Note”. Ky trajnim është zhvilluar pranë shkollës së Mesme Profesionale “Kolin Gjoka”, Lezhë. Në trajnim kanë marrë pjesë 21 të rinjë dhe të reja të cilët janë njohur me formatin baë të shkrimikt ë një “Concept Note”. Trajnere për këtë trajnim ka qënë Znj.Vasilika Laska . Në fund të trajnimit pjeëmarrësit janë pajisur me çertifikatë pjesëmarrjeje.



“Contact Making Seminar”



Të përfaqësuar nga Znj. Vasilika Laska, Koordinatore e Përgjithëshme, organizata “Social Inclusion for Development” ishte pjesë e aktivitetit “Contact Making Seminar”, të mbajtur në Krusevo, në Maqedoninë e Veriut!

Pjesëmarrja në këtë aktivitet u mundësua nga organizata “PVN Albania”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja dhe ndërtimi i urave të komunikimit ndërmjet organizatave të ndryshme në Ballkan dhe në Europë. Gjatë seminit organizatat pjesëmarrëse të prezantonin punën që bëjnë, target grupet dhe të njoheshim me bashlkëpunëtor të mundshëm në fushën e projekteve e jo vetëm kuadër të programit Erasmus for All.



Dita e Karrierës në bashkëpunim me “Albanian Skills”

Në bashkëpunim me organizatën Albanian Skills kemi zhvilluar aktivitetin e quajtur “Dita e Karrierës”. Ky aktivitet adresonte nevojën që kanë të rinjtë dhe të rejtat për shërbimin e këshillimit për karrierë. Metodologjia e përdorur gjatë këtij aktiviteti ishte mikse, duke përdorur prezantime, punë në grupe dhe metoda të tjera të edukimit joformal. Programi i këtij aktiviteti ishte:

- Shkollë-Profesion-Punë- Vasilika Laska Koorditore e Përgjithëshme "Social Inclusion for Development"
- Vlerat dhe rëndësia e tyre në zhvillimin profesional- Ana Zacharian; Drejtuese, Albanian Skills
- Edukimi Digital dhe Aftësitë digitale- Edison Biba Trajner, Themelues dhe Drejtues LEETO Agency, Go Leeto mbështetës i kësaj nisme.
- Mendimi kritik, argumentimi për aktivizmin dhe kauzat sociale- Entela Gjyla; Researcher & Këshilluese Karriere, Albanian Skills
- Punë në grupe nga të rinjtë e të rejtat pjesëmarrëse dhe prentime të punës në grupe,

Pjesëmarrja dhe përfshirja aktive e të rinjve në diskutime dhe detyrat praktike të realizuara përforcon edhe njëherë nevojën e madhe që të rinjtë anembanë Shqipërisë kanë për t'u takuar, folur dhe orientuar në zhvillimin e tyre personal dhe profesional.



Ekspozitë “N’Shesh T’Burrave Pa Burri” në bashkëpunim me Qendra “H.A.N.A”

Në bashkëpunim dhe me ftesë të Qendrës “H.A.N.A” zhvilluam në Lezhë ekspozitën “N’Shesh T’Burrave Pa Burrni”. Kjo ekspozitë u mbajt në datë 8 Mars në Ditën Ndërkombëtare Dedikur Grave dhe Vajzave në mbarë botën.

Në posterat e përgatitur për këtë ekspozitë pasqyrojmë gjuhën e urrejtjes që vërshon lirshëm në rrjete sociale prej dhunuesve të fshehur në liri; ekspozuam patronizimin që i bëhet vajzës e gruas që guxon të dalë jashtë pritshmërive të shoqërisë; ekspozuam shifrat e vrasjeve dhe torturave ndaj motrave tona anë e kënd Shqipërisë e u përpoqëm të edukojmë vizitorët me termat kryesorë të betejës për liri e drejtësi të vajzave e grave.

Kjo ekspozitë ishte publike dhe u vendos në Qendër të Lezhës dhe qytetarë e kalimtarë të shumtë patën mundësinë të shikonin të ekspozuar konkretisht realitetin e hidhur në të cilin jetojnë e punojnë gratë e vajzat në Shqipëri”.



"ESC Buddy Support System"

SIFD" përgjatë periudhës Qershor-Shtator ka qënë pjesë e 18 organizatave të përzgjedhura në Programin "ESC Buddy Support System".


Kjo masë është projektuar nga SALTO SEE për të mbështetur cilësinë dhe sasinë e projekteve vullnetare brenda Korpusit Evropian të Solidaritetit (ESC) në Ballkanin Perëndimor (BB).

Masa synon të mbështesë një nga dy aspekte:

1. rritja e cilësisë (përputhja e dy organizatave, të cilat ndajnë realitete të ngjashme për të transferuar njohuri konkrete nga një organizatë më me përvojë në një organizatë me më pak përvojë, në mënyrë që të aktivizojnë organizatën me më pak përvojë (domethënë që ata fillojnë të dërgojnë/strehojnë vullnetarë)
2. përmirësimi i krijimit të partneritetit (përputhja e një organizate pa përvojë nga BB me një organizatë me përvojë nga vendi pjesëmarrës i ESC që mban një Etiketë Cilësie për rolin udhëheqës në ESC)

SIFD pati mundësinë që në këtë rrugëtim të ishte në "Body" me një prej organizatave më të mëdha në POLONI Stoëarzyszenie POLITES.

Në kuadër të këtij prgrami kemi realizuar dhe një sesion informuese për European Solidarity Corps me të rinjë aktiv të SIFD dhe vullnetarë të POLITES.



Different-Together-Strong, Interreligious and interconvictional dialogue from a woman's perspective'

SIFD përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive Znj.Marjana Dedaj ka qënë pjesë e aktivitetit me temë "Different-Together-Strong, Interreligious and interconvictional dialogue from a woman's perspective' të mbajtur në Augsburg Gjermani.

Gjatë këtij aktiviteti pjesëmarrësit kanë diskutuar dhe ndarë eksperiencat e tyre lidhur me rëndësinë që ka dialogu ndër-fetar në komunitetet tona sidomos në këtë kohë të vështirë që bota po kalon sot dhe konfliktet fetare janë akoma relevante.



"TOSCA Training"

SIFD ka qënë një nga 24 organizatat pjesëmarrëse në Ostendee, Belgjikë për "TOSCA Training" mbi programin e European Solidarity Corps për të mësuar më tepër mbi këtë program dhe fillimin e shkëmbimit të vullnetarëve ndërmjet Social Inclusion For Development dhe organizatave të ndryshme në Europë pas certifikimit të SIFD me etiketën e cilësisë "Quality Label" por dhe për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit në projekte të ndryshme në kuadër të Programit ERASMUS +.

Ky trajnim ndihmon stafin tonë që të kenë një përgatitje të plotë profesionale për të menaxhuar vullnetarë si për të dërguar jashtë Shqipërisë ashtu edhe për të mirëpritur vullnetarë të huaj në organizatën tonë.

Qëllimi i trajnimit synon mbështetjen dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatave që marrin pjesë aktive në projektet e vullnetarizmit nëpërmjet programit të European Solidarity Corps, për të garantuar cilësi dhe ndikim në projektet përkatëse.



Paqja dhe Sporti

Përmbyllja e Javës së Paqes 2023, si iniciativë e United Nation Association Albania u mbajt në Lezhë, nismën e pestë lokale "Sporti dhe Paqja". SIFD me Koordinatorën Znj. Vasilika Laska dhe KVR Lezhë u kujdesën për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit. Në Lezhë, u dëshmuua drejtpërdrejt se si sporti mund të kapërcejë ndarjet, të ndërtojë komunitete dhe të nxisë konkurrencë të shëndetshme. Në fushë individë të rinj me prejardhje të ndryshme u mblodhën, jo si kundërshtarë, por si shokë skuadre që punonin drejt një qëllimi të përbashkët. Nëpërmjet çdo pasimi, pikë dhe brohoritje, ne pamë potencialin e sportit për të rrënjosur vlerat e respektit, bashkëpunimit dhe vendosmërisë.



Youth Leader Workshop on Advocacy & Partnership Building.

SIFD ishte pjesë e Workshopit "Youth Leader Workshop on Advocacy & Partnership Building" të mbajtur në Podgoricë, Mali I Zi në datat 31 Tetor-3 Nëntor 2023.

Qëllimi i këtij Workshop-i ishte të fuqizojë liderat rinor të cilët do të angazhohen të rinjtë në nivel lokal e kombëtar për angazhim social dhe ti mbështesë ata në zbatimin e iniciativave lokale/kombëtare në të mirën e të gjithë komunitetit. Gjatë workshop-it 4-ditor, 30 Youth Leader nga WB6 kanë trajtuar temat e ndërtimit të partneritetit, advokimit dhe shkrim-leximit mediatik dhe dixhital përmes metodologjisë së të mësuarit të shërbimit, (service-learning). Ky workshop do të pasohet me aktivitete dhe nisma lokale në Shqipëri, Bosnia & Herzegovina, Mali I Zi, Kosova, Maqedoni e Veriut dhe Serbia.



Takim me Vullnetarët e Korpusit të Paqes

SIFD pati kënaqësinë dhe nderin që për të dytin vit rradhazi të ishte një nga organizatat e përzgjedhura në Lezhë për të ndarë eksperiencën e tyre në fushën e shoqërisë civile me Vullnetarët e Korpusit të Paqes.

Gjatë diskutimit me këta vullnetarë ne prezantuam punën që ka bërë SIFD gjatë këtyre viteve në Lezhë duke u përqëndruar në këto pika:

1. Target grupi tek I cili jemi të orientuar.
2. Fushat dhe Prioritet që janë fokusi I punës së SIFD.
3. Projektet dhe iniciativat e zbatuara deri tani.
4. Vazhdimi në përmbushjen e Misionit dhe Vizionit të Social Inclusion For Development.

Ky takim ishte I rëndësishëm sepse jo vetëm na jep mundësinë të ndajme eksperiencën e punës që ne bëjmë por shërben dhe si moment reflektimi mbi ato çfarë janë realizuar dhe çfarë duhet të bëjmë në vijim të përmbushjes së rolit tonë si organizatë e orientuar në përmirësimin e cilësisë së jetes në komunitetin e Lezhës, bazuar në vlerat që SIFD ka si gur themeli të tij si qytetaria aktive, integriteti, vullnetarizmi, bashkëpunimi dhe partneriteti.



Dialogu Rinor - Ndërthurja e Ideve dhe Energjisë Rinore për Një Ndryshim Pozitiv në komunitet"

Në Ditën Kombëtare të Rinisë, Këshilli Vendor Rinor Lezhë pranë Qendrës Rinore Lezhë organizoi eventin "Dialogu Rinor - Ndërthurja e Ideve dhe Energjisë Rinore për Një Ndryshim Pozitiv në komunitet" në bashkëpunim me "Social Inclusion for Development". Gjatë eventit të rinjtë ndanë histori frymëzuese që inspirojnë nxitjen e rinisë për ndryshim shoqëror dhe organizuan grupe pune me temë "Lezha në optikën e të rinjve", ku zëri i të rinjve mori vëmendjen e duhur për të promovuar rëndësinë për formimin e një shoqërie më të përfshirë, evoluese dhe kreative.

Gjithashtu kjo ditë shënoj dhe themelimin e Rrjetit Rinor "Lezha Future Leaders". Themelimi i këtij rrjeti rinor është një iniciativë vullnetare ndërmjet SIFD, KVR Lezhë dhe Qendres Rinore Publike pranë Bashkisë Lezhë.

Lezha Future Leaders synon të nxisë zhvillimin e lidërshiptit, angazhimin qytetar dhe ndërtimin e sensit të komunitetit duke bashkuar një grup të rinjsh. Qëllimi ynë është t'i fuqizojmë ata me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të rritur aftësitë e tyre drejtuese dhe për të krijuar një ndikim pozitiv në komunitetet e tyre.



Rinia N' Festë



Mbyllja e Vitit 2023

Aktiviteti "Rinia n'Festë" u organizua nga grupi rinor Lezha Future Leaders, në Qendrën Rinore Lezhë, me mbështetjen e organizatës SIFD dhe Keshillit Vendor Rinor.

Ky aktivitet kishte si synim të risillte në kujtesë traditën e shkruarjes së kartolinave për festat e fundvitit, si dhe poezive apo thëniet që janë përdorur masivisht në dekadat e kaluara.



PROJEKTE

VOZISIM N'DRIN

UNË, BASHKIA DHE KËSHILLI BASHKIAK

EDUKIMI LIGJOR I QYTETARËVE TË LEZHËS NË KUADËR TË REFORMËS
ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE 2014.

VOZISIM N'DRIN

Projekti "Vozisim n' Drin" erdhi si një përpjekje e organizatës Social Inclusion for Development me qëndër në Lezhë për të përmirësuar cilësinë e jetesës për komunitetin e Bashkisë Lezhë në tërësi dhe grupet në nevojë në veçanti duke promovuar turizmin, mjedisin dhe shëndetin. Falë këtij projekti, një sërë aktivitete janë realizuar me të rinj, të reja, burra dhe gra.. Për të mbajtur gjallë këtë traditë të re që promovon shëndetin fizik dhe mendor, turizmin ujor, mbajtjen pastër të mjedisit, vimë me projektin "Vozisim n'Drin".

Projekti është zhvilluar në kuadër të Programit Rajonal për Zhvillimin e Demokracisë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i financuar nga Bashkia Lezhë.

Objekti i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë cilësinë e jetesës për komunitetin e Bashkisë Lezhë nëpërmjet përfshirjes sociale në aktivitete sportive dhe mjedisore.

Objekti i specifik 1, projekti synon rivitalizimin e aktivitetit në lumin Drin nëpërmjet sportit me kajakë dhe me përfshirjen aktive të burrave, grave, djemve dhe vajzave , turistë vendas dhe të huaj në Bashkinë Lezhë.

Objekti i specifik 2 synon të kontribuojë në promovimin e një stili të shëndetshëm jetese në një mjedis të pastër dhe tërheqës për banorët dhe turistët e Bashkisë Lezhë

Rezultati 1. 144 persona janë për përdorimin e kajakëve dhe vozisin në lumin Drin. Kështu, pas përfundimit të projektit, 144 burra, gra, djem dhe vajza mes të cilëve persona me aftësi të kufizuara, banorë të komunitetit rom dhe egjiptian, persona që vuajnë dhe luftojnë kundër kancerit të gjirit etj, kanë ndjekur trajnimet mbi zbatimin e rregullave të vozitjes dhe njohin efektet pozitive fizike dhe psikologjike të angazhimit në këtë sport. Për një vozitje të mirë dhe për të nxitur konkurrencën janë blerë 10 lopata, 10 xhupa shpëtimi dhe 4 kajakë. Gjithashtu, 8 kajakë janë riparuar dhe vënë në ripërdorim.

Rezultati 2: 70 persona janë trajnuar dhe kanë marrë informacion për përfitimet shëndetësore dhe psikosociale si rezultat i përfshirjes në sport. Në këtë rezultat kemi 70 persona të ndarë sipas kategorive të përcaktuara në fillim të projekt propozimit, përfshirë edhe ndjeshmërinë gjinore, janë trajnuar mbi kujdesin për ambientin dhe mbajtjen pastër të lumit Drin.

Rezultati 3: 10 persona dhe komuniteti janë angazhuar dhe kanë kontribuar në mbajtjen pastër të lumit Drin . Sipas këtij rezultati, lumi Drin është më i pastër dhe përshkohet nga një vozitje e lirë me kajakë.

Rezultati 4. 25 të rinj të grpmoshës 15-25 vjeç, përfshirë këtu edhe të rinj nga shtresat në nevojë kanë marrë pjesë në një garë me kajak n'Drin. Bazuar në këtë rezultat, 1 garë me kajak është organizuar në lumin Drin dhe marrin pjesë 20 të rinj të grupmoshës 15-25 vjeç.

Rezultati 5. Është realizuar festivali n'Drin dhe realizuar spoti final i projektit.



Objekti i performancës	Propozimi	Arritja
R.1 – 70 persona trajnohen për përdorimin e kajakeve dhe vozisin në lumin Drin	70	144
R.2 – 70 persona trajnohen dhe marrin informacion për përfitimet shëndetësore të angazhimit në sportin me kajake.	70	70
R.3 – 70 persona angazhohen në fushatë ndërgjegjëse dhe kontribuojnë në mbajtjen pastër të lumit Drin.	70	100
R.4 – 20 të rinj marrin pjesë në gara me kajakë	20	25
R.5 – Event i final "Festival n'Drin"	1	1
Bluza me logo të donatorit dhe organizatës zbatuese	50	30
Ditë trajnimi teorik për përdorimin e kajakëve	4	4
Ditë praktike dhe Vozitje e lirë	16	16
Trajnimi për edukimin mjedisor dhe përfitimet shëndetësore	4	4
Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për mbajtjen pastër të lumit Drin	2	4
Takime me nxënës të shkollave	2	2
Takime me qendra që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara	2	2
Publikimi në media vizive	1	3
Spot i ndërmjetëm të vozitjes në lumin Drin	1	1
Pllakate vizibiliteti	1	1

VOZISIM N'DRIN

Aktiviteti 1: Prezantimi i Projektit

Eshte realizuar prezantimi i projektit "Vozisim n'Drin", ku pjesemarrësit janë njohur me qëllimin dhe objektivat e projektit, si dhe financuesin e tij. Në këtë prezantim kanë marrë pjesë rreth 65 persona, qytetarë, përfaqësues institucionesh dhe organizatash të shoqërisë civile. Ata janë ftuar të behen pjesë e aktiviteteve të projektit. Pasi është realizuar hapja e nisjes së projektit, është vazhduar me aktivitetet konkrete me përfituesit e tij,



Aktiviteti 2: Trajnimi mbi Kajakët

Aktiviteti nr.2 lidhet me trajnimin e 70 personave përfitues të projektit duke përfutur njohuri mbi përfitimet shëndetsore dhe mjedisore të angazhimit në sportin me kayakë. Në lidhje me këtë aktivitet për muaj me radhe janë realizuar 4 trajnime me një total përfituesish rreth 70 persona, prej të cilëve 15 kanë qënë gra me urdhër mbrojtje dhe përfitues të ndihmës ekonomike. Këto trajnime janë realizuar nga eksperti i shëndetit i kontraktuar si ofrues shërbimi. Përfituesit e trajnimit janë njohur me përfitimet shëndetsore, fizike dhe mendore si dhe ndikimin që ka në mjedis angazhimi në sportin me kayakë, si ky lloj sporti ndikon në ndryshimin e mendësisë për zhvillimin e një stili të shëndetshëm jetese. Trajnimi është mirëpritur nga të gjithë përfituesit.

Aktiviteti 3: Fushata Ndërgjegjëse

Aktiviteti i 3-të lidhet me organizmin e 2-fushatave ndërgjegjëse për mbajtjen pastër të lumit Drin. Sipas planit të aktiviteteve janë parashikuar 4 fushata ndërgjegjëse për mbajtjen pastër të mjedisit dhe sidomos mbajtjen pastër të lumit Drin. Në çdo ditë praktike është folur për të mbajtur pastër lumin Drin, por pas vizitës së lirë, një moment i vevantë i është kushtuar nga vetë pjesëmarrësit aktivitetit ndërgjegjëses për mbajtjen pastër të lumit, duke mbledhur mbetjet dhe plastikën përgjatë lumit Drin duke filluar që nga moli përballë Memorialit të Skënderbeut, më pas është bërë një parade me thasë e mbetjeve për të përcjellë mesazhin se "mbrojtja e mjedisit është një detyrë e të gjithëve". Për shkak të ndryshimit të ligjit për pagën minimale, me aprovimin e Bashkisë Lezhë është bërë alokimi i këtij fondi në zërin e pagës për menaxherin e projektit, rrjedhimisht këto aktivitete janë realizuar me kosot zero nga projekti dhe janë mbuluar me punën vullnetare të aktivistëve të organizatës Social Inclusion for Development.



Aktiviteti 4: Gara me Kajakë

Aktiviteti 4 lidhet me zhvillimin e garave me kayakë. Në këtë aktivitet u përfshinë 20 të rinj dhe të reja. U zhvilluan gara me kayakë dhe vizitje e lirë, u shpërndanë 3 çmime për vizitësit më të mirë, si dhe certifikata mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit. Një bukuri të veçantë këtij event i ka dhënë këngëtarja Denisa Delia e cila me zërin e saj të bukur dhe guximin që e karakterizon, ka performuar më 3 këngë duke vizituar në kayakë në mës të lumit Drin. Ky aktivitet është mirëpritur nga shumë qytetarë të Bashkisë Lezhë dhe jo vetëm.

Aktiviteti 5: Festival N' Drin

Aktiviteti i 5-të u finalizua me organizmin e eventit "Festival n'Drin". Gjatë këtij aktiviteti performuan të rinj të talentuar në Lezhë me këngë e valle por edhe me mesazhe sensibilizuese për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e lumit Drin. Pjesë e aktivitetit ishin edhe Trupa e Baletit dhe Valleve të qytetit të Lezhës "Eagle Dance", të cilët nën koreografinë e Maestro Gazmend Golemi i shtuan ngjyrat festivalit. Eventi final numëroi rreth 60 pjesëmarrës, të rinj dhe të reja, qytetarë këmbësorë në shëtitore, burra dhe gra dhe shumë fëmijë që iu gëzuan ritmeve të muzikës. Media vizive ishin të ftuar në këtë event, si : Top Channel, Klan Tv, Syri Tv, Report Tv, MCN etj. Pjesëmarrja e tyre ishte me shumë rëndësi pasi në këtë mënyrë ky sport promovohet dhe merr përmasa më të gjera, duke i dhënë një shtysë më të madhe zhvillimit të turizmit sportive, ujqor në Bashkinë Lezhë. Eventi u shoqërua me fjalën përshëndetëse të përfaqësuesit të Bashkisë Lezhë Z. Elson Frroku. Në këtë event, Bashkisë Lezhë i është dhuruar një pllakatë vizibiliteti me logot e projektit, dhe i rekomandohet që të ndjekë me tej zhvillimin e këtij sporti argetues dhe të shëndetshëm.



VOZISIM N'DRIN



Organizata “Social Inclusion for Development” ka përfunduar zbatimin e projektit “Unë, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak”. “Ky projekt/aktivitet organizohet në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.”

Projekti ka pasur në fokus në shtylla.

- a. Së pari në trajnimin e të rinjve të 10 Njërive Administrative të Bashkisë Lezhë mbi, vlerat, parimet dhe funksionimin e Institucioneve të qeverisjes vendore (Këshillat Bashkiak dhe Bashkia).
- b. Shtylla e dytë e projektit ka qënë organizimi i një simulimi (Model i Simulimit të Institucioneve Vendore) ku do të bëhet një simulim se si funksionon Këshilli Bashkiak.
- c. Shtylla e Tretë e Projektit ka konsistuar në draftimin e një Planit Strategjik “Për Rininë 2023-2027” të Bashkisë Lezhë, në bashkëpunim më Bashkinë Lezhë. Në këtë Draft Plani Strategjik do të parashikohen prioritetet që do të ketë Bashkia Lezhë në fushën e Rinisë për periudhën 4-vjeçare nga viti 2023 deri në vitin 2027.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është “Të rinjtë e Lezhës do të njihen me vlerat dhe parimet e funksionimit të qeverisjes vendore, të bëhen promotorë të tyre dhe nxitës për hartimin e një plani strategjik për rininë 2023-2027”. Ky qëllim është zbrëthyer në 3 objektiva specifik të cilët janë:

Objektivi specifik 1: Të rrisim kapacitetet e 45-50 të rinjve të Lezhës të grupmoshës 15-29 vjeç sa i takon vlerave, parimeve dhe funksionimit të Institucioneve të qeverisjes vendore (Këshillat Bashkiak dhe Bashkia).

Objektivi specifik 2: 20-25 Të rinjëangazhohen dhe demonstrojnë funksionimin e Institucioneve të qeverisjes vendore (Këshillat Bashkiak dhe Bashkia) dhe nxiten që të jenë më të përfshirë në institucionet vendimmarrëse.

Objektivi specifik 3: Të hartojmë draft planin strategjik “Për Rininë 2023-2027”, në Bashkinë Lezhë”.

Nga ky projekt janë arritur këto rezultate nga aspekti cilësor:

Rezultati i Parë: Të rinjtë që jetojnë në territorin e Bashkisë Lezhë njohin vlerat, parimet dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve drejtuese lokale. Ky rezultat është arritur nëpërmjet tranimit të realizuar mbi “Parimet, vlerat, kompetencat dhe funksionimi i qeverisjes vendore (Bashkia & Këshilli Bashkiak)”, vizitës studimore në Bashkinë Lezhë dhe ndjekjes së Mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

Rezultati i Dytë: Të rinjtë që jetojnë në territorin e Lezhës janë të aftë të kuptojnë dhe veprojnë rolin e këshilltarëve bashkiak në Këshill Bashkiak. Për arritjen e këtij rezultati është realizuar Simulimi i Këshillit Bashkiak, ku 25 të rinjtë të cilët jetojnë në territorin e Bashkisë Lezhë kanë qënë në rolin e këshillit bashkiak dhe kanë vepruar në rolin e tyre sipas një rendi dite të përcaktuar nga vetë ata. Gjithashtu në funksion të këtij rezultati por edhe të simulimit është zhvilluar workshop-i 3 ditor mbi mënyrën e funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe roli i secilit anëtar të këtij këshilli.

Rezultati i Tretë: Të rinjtë duke njohur më mirë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve janë të gatshëm që të përfshihen më shumë në institucionet vendimmarrëse publike vendore. Gjithashtu ky rezultat është arritur nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të përmendura edhe në Rezultatit 1 dhe 2.

Rezultati i Katërt: Është hartuar drafti i Planit Strategjik “Për Rininë 2023-2027”.

UNË, BASHKIA DHE KËSHILLI BASHKIAK



Objektivi i performancës	Propozimi/ Pjesëmarrës	Arritja
Prezantimi i Projektit	20	36
Trajnimi mbi vlerat parimet dhe funksionimin e institucioneve të qeverisjes vendore (Bashkia dhe Këshilli Bashkiak)	45	45
Vizita Studimore në Bashkinë Lezhë	15	16
Simulimi i Funksionimit të Këshillit Bashkiak	25	25
Sesione Informuese mbi Simulimin (3 Sesione)	30	62
Workshop 3 ditor mbi mënyrën e Funksionimit të Simulimit	25	25
Pjesëmarrje në Mbledhje të Këshillit Bashkiak	15	16
Pyetësor për Draft Strategjië	25	51
Tryeza Të Rrumbullakëta për Konsultim mbi Draft Strategjinë	15-20	21
Hartimi i Draft Strategjisë “Për Rininë 2023-2027”	1	1
Konferenca Finale e Projektit Duke qënë periudhë zgjedhore nuk ka pasur pjesëmarrje nga institucionet qeverisëse vendore vetëm kemi pasur prezencë të Specialistit të Rinisë. Gjithashtu shumica e institucioneve arsimore vazhdojnë që të jenë skeptike ndaj shoqërisë civile dhe refuzojnë që të përfshihen apo të marrin pjesë në projekte e nisma që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile. Në emailin njoftues janë njoftuar 89 individë nga Lezha por nuk kanë marrë pjesë.	45	31

UNË, BASHKIA DHE KËSHILLI BASHKIAK

Aktiviteti 1: Prezantimi i Projektit

Në këtë aktivitet është bërë prezantimi i projektin. Takimi ka startuar me fjalën e Znj. Denisa Karaçi e cila është anëtare e bordit drejtues të organizatës “Social Inclusion for Development”. Ajo bëri një prezantim të shkurtër të historikut të organizatës për pjesëmarrësit duke u ndalur tek iniciativat e marra së fundmi nga kjo organizatë. Gjithashtu në emër të SIFD dhe drejtueses ekzekutive të kësaj organizatë Znj. Marjana Dedaj ajo falenderoj Kongresin Rinor Kombëtar për vlerësimin e këtij projekti si fitues. Për pjesëmarrësit është bërë prezantim edhe programin “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022” dhe bëri një përmbledhje të veprimarisë së Kongresit Rinor Kombëtar. Pastaj Znj. Laska bëri një prezantim të detajuar të projektit “Unë, Bashkia dhe Këshilli Bashkia”, duke u përqëndruar tek qëllimi, objektivat, aktivitetet, rezultatet, target grupi dhe bashkëpunëtorët. Pas prezantimit të projektit nga Znj. Laska fjalën e kaloi tek Përfaqësuesi i Bashkisë Lezhë, Z. Altin Përgjegjësi i cili është Përgjegjës për Rininë dhe Sportet në Bashkinë e Lezhës. Ai përshëndeti projektin dhe e vlerësoi si një risi për të rinjtë e Lezhës dhe jo vetëm. Gjithashtu ai u shpreh që ky projekt dhe stafi i projektit do të kenë mbështetjen e instancioneve qeverisëse vendore gjatë gjithë zbatimit të projektit. Në takim morën pjesë 36 pjesëmarrës, ku ndër të cilët kishte prezencë të institucioneve publike, të rijëve, organizatave rinore dhe organizatave të shoqërisë civile.



Aktiviteti 2: 2 Trajnime


Trajnimit të rinjve mbi temën “Parimet, vlerat, kompetencat dhe funksionimi i qeverisjes vendore (Bashkia & Këshilli Bashkia). Tema mbi të cilat është diskutuar gjatë këtij trajnimit janë: QEVERISJA VENDORE, Çfarë kuptojmë me autonomi vendore, Decentralizmi, LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE, Misioni i vetëqeverisjes vendore, Parimet themelore të vetëqeverisjes vendore. Në ditën e dytë të trajnimit u shpjeguan me detaje nga trajnuesja Organet e qeverisjes vendore dhe kompetencat e tyre. Organigrama e Bashkisë Lezhë dhe strukturimi i saj. Funksionet dhe kompetencat e Bashkisë dhe Këshillit Bashkia. Gjithashtu u shpjegua për pjesëmarrësit Qarku si institucionet dhe funksionet e Këshillit të Qarkut. Ndërsa në ditën e tretë të trajnimit u preken temat të cilat lidhen me Të Drejtën e Informimit dhe Konsultimit Publik.



Aktiviteti 3: Simulimi

Në Kuadër të aktivitetit 3 të këtij projekti janë realizuar disa nënaktivitete:

1. Vizitë në Mbledhjen e Këshillit Bashkia. Takimi është zhvilluar zhvillua në ambientet e Qendres Kulturore të Fëmijëve aty ku zhvillohen Mbledhjet e Këshillit Bashkia. Në takim morën pjesë 19 pjesëmarrës, të rinj të cilët janë banor të Bashkisë Lezhë dhe Njësi Administrative. Gjatë kësaj mbledhje të rinjtë kishin mundësinë që të shikonin se si organizohet dhe zhvillohet një mbledhje e këshillit bashkia. Të njiheshin më qartë me strukturën dhe përbërjen e një Këshilli Bashkia si dhe të kuptonin funksionet e secilit anëtar në këshill.
2. Shvizitë Studimore në Bashkinë Lezhë . Në këtë aktivitet morën pjesë 16 pjesëmarrës, të rinj të cilët janë banor të Bashkisë Lezhë dhe Njësi Administrative. Gjatë kësaj vizite ata patën mundësin të vizitonin jo vetëm ambientet e bashkisë por të njiheshin nga afër me disa prej drejtorive e sektorëve të kësaj bashkie si: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sektori i Protokollit e Arkivës si dhe Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës.
3. Organizimi i 3 Sesioneve Informuese në Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë.
4. Workshop-i 3 ditor mbi Simulimi
5. Trajnimi mbi të Folurisë në Publik dhe 6 Simulimi.



Aktiviteti 4: Draftimi i Strategjisë për Rininë

Hartimi i një dokumenti strategjik për sektorin e rinisë është e parashikuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 (PSZHQ) në Qëllimin ‘Cilësia e jetës dhe komuniteti’. Ndërkohë në tërësi ky dokument synon të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë atë ekonomik, social, mjedisor e kulturor. Vizioni i PSVR-së është ‘Vendosja e rinisë në fokus të jetës aktive’. Në këtë frymë, PSVR synon të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Nën këtë vizion, PSVR projektin krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre. Prioritet është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, kulturë dhe sigurimin e mundësive për pjesëmarrje të të rinjve në shoqëri dhe vendimmarrje.

Aktiviteti 5: KONFERENCA LOKALE “UNË, BASHKIA DHE KËSHILLI BASHKIAK”

Kjo konferencë ka bërë bashkë 32 pjesëmarrës të rinjë aktivistë, vullnetarë, të punësuar, të rinjë të papunë, profesionist në fusha të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile lokale dhe kombëtare, aktor të institucioneve publike dhe jopublike për të diskutuar sëbashku mbi mënyrat e përfshirjes akoma më shumë të të rinjve në institucionet vendimmarrëse publike vendore. Për të qënë prezentë në konferencë janë dërguar dhe njoftuar 89 persona/individë, përfaqësues të institucioneve të qeverisjes vendore si anëtar të këshillit bashkia, përfaqësues na qarku lezhë dhe institucionet arsimore por nuk kishim pjesëmarrje nga ata. Gjatë konferencës gjithashtu është bërë një prezantim i Draft Strategjisë së hartuar dhe i rezultateve të projektit, impaktit të tij në vazhdimësi si dhe hapësirave për vazhdimësinë e qëndrueshmërisë së projektit. Gjatë konferencës është bërë edhe një prezantim i rezultateve dhe arritjeve të projektit.



Organizata “Social Inclusion for Development” ka zbatuar projektin “Edukimi ligjor I qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014”, i cili zbatohet me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlëra të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” i zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në partneritet me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Center for Research and Policy Making (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Qëllimi I këtij projekti është “Edukimi Ligjor I qytetarëve të Lezhës, kryesisht të rinjve dhe grave të grup moshës 15-45 vjeç sa I takon reformës administrative territoriale dhe funksioneve e kompetencave të qeverisjes vendore.

Objektivi specifik 1: Të zhvillojmë një fushatë informuese mbi funksionet dhe kompetencat e institucioneve vendore në 10 Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Lezhë, duke përfshirë dhe organizatat e shoqërisë civile.

Objektivi specifik 2: Të advokojmë në Bashkinë Lezhë dhe Këshillin Bashkiak për ngritjen e pozicionit të “Koordinimit të Edukimit Ligjor”, sipas Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023.

Rezultati: 50 qytetarë të Lezhës, kryesisht të rinj dhe gra njohin më saktë dhe qartë institucionet e qeverisjes vendore, kompetencat që këto institucione kanë dhe shërbimet që ato duhet të ofrojnë për qytetarët e Lezhës. Këto qytetarë janë të rinjë dhe gra të njësive administrative dhe zonave rurale si Shënkolli, Rrila, Gajush, Tale 1, Pllanë, Kallmet, Rraboshtë, Mërqi, Zejmen dhe Tale 2.

Rezultati 2: Është zhvilluar një fushatë advokuese për ngritjen e pozicionit të “Koordinatorit të Edukimit Ligjor”, pranë Bashkisë Lezhë. Në tryemë e rrumbullakët të relizuar nga ky projekt ka patur pjesëmarrës nga Këshilli Bashkiak Lezhë të cilët e kanë mirëpritur idenë e një koordinatori për edukim ligjor dhe janë shprehur që një nevojë e till për Lezhën është koherente por edhe sugjeronin që mbase ky koordinator mund të mos jetë vetëm në nivel bashkie por në nivel prefekturë ose qarku.

Gjithashtu është hartuar një Plan Lokal Veprimi për Edukimin Ligjor për vitet 2024-2027 sipas Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023.

1 Rrjet Organizatash të Shoqërisë Civile është ngritur nëpërmjet një memorandumi bashkëpunimi për Monitorimin dhe Zbatimin e Planit Lokal të Veprimit.

Nga aspekti sasior ky projekt deri në këtë fazë ka arritur të ketë këto produkte:

- 2 workshope janë realizuar në 10 Njësi Administrative me 50 përfitues.
- 1 Fushatë Edukuese është zvilluar online
- 1 Tryezë e Rrumbullakët është zhvilluar me 25 përfitues, me presence të Kryetari i Këshillit Bashkiak, Nënkryetari i Këshillit Bashkiak dhe Sekretaria e Këshillit Bashkiak Lezhë, Këshilli Vendor Rinor pranë Bashkisë Lezhë, NJVKSH Lezhë, organizatat e shoqërisë civile në Lezhë e ekspertë nga shoqëria civile në Tiranë, aktivistë të qytetit dhe komuniteti i Lezhës.
- 1 Plan Lokal Veprimi 2024-2027 për Edukimin Ligjor të Publikut është hartuar
- 1 Rrjet Organizatash të Shoqërisë Civile është ngritur nëpërmjet një memorandumi bashkëpunimi për Monitorimin dhe Zbatimin e Planit Lokal të Veprimit.

EDUKIMI LIGJOR I QYTETARËVE TË LEZHËS NË KUADËR TË REFORMËS ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE 2014.



Objektivi i performancës	Propozimi/ Pjesëmarrës	Arritja
Workshope të realizuar	2	2
Pjesëmarrës në workshope	50	50
Fushatë Informuese/Edukuese online	1	1
Postera të prodhuar për fushatën	15	15
Postime për fushatën (INSTA/FB SIFD) INSTA (Këshilli Rinor Vendor)	45	45
Tryezë e rrumbullakët	1	1
Pjesëmarrës gjatë tryezës së rrumbullakët	20	25
Plan Lokal Veprimi mbi Edukimin Ligjor	1	1

EDUKIMI LIGJOR I QYTETARËVE TË LEZHËS NË KUADËR TË REFORMËS ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE 2014

Aktiviteti 1: 2 Workshop-e

WORKSHOP 1: Në datë 02.06.2023 organizata "Social Inclusion for Development", zhvilloi aktivitetin e parë në kuadër të projektit "Edukimi ligjor i qytetarëve të Lezhës në kuadër të reformës administrative-territoriale 2014". Aktiviteti nisi në orën 11:30 deri në orën 13:30 Në takim morën pjesë 29 pjesëmarrës, ku ndër të cilët kishim prezent 6 gra dhe 23 të rinjë nga Njësia Administrative Shënkoll duke përfshirë këtu fshatrat si Rrila, Shënkolli, Tale 1&2, Gajush, Pllan dhe zonat përreth.

NNë Workshopin e dtë kishim prezent përfitues nga Njësia Administrative Kallmet duke përfshirë këtu fshatrat si Kallmeti, Rraboshta si dhe nga qyteti i Lezhës.

Workshopi ishte ndarë në dy sesione. Në sesionin e parë mbi ligjin për reformën administrative-territoriale 2014 është diskutuar mbi këto pika:

1. Çfarë është kjo reformë?
2. Çfarë ndikimi kishte kjo reformë në decentralizimin e pushtetit lokal.
3. Çfarë ndryshimesh parashikoheshin në këtë ligj.
4. Si ndahet pushteti vendor nga ai qendror.



NënAktiviteti 1.2 Fushatë Informuese

FUSHATA INFORMUESE: Gjatë muajit të dytë të zbatimit të projektit është realizuar fushata informuese në median social elidhur me funksionet dhe kompetencat e qeverisjes vendore. 15 postera dhe postime janë prodhuar për këtë fushatë të cilat janë postuar në rrjetet sociale të organizatës "Social Inclusion for Development" dhe "Këshillit Rinor Vendor" pranë Bashkisë Lezhë. Mediat sociale të përdorura kanë qënë Instagram dhe Facebook.

Përmbajtja e postimeve ka qënë: Qeverisja Vendore, Reforma administrativo-territoriale, Decentralizimi, Njësiti e vetëqeverisjes vendore, Nendarjet e Bashkisë, Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, Bashkia, Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, Qarku, Të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore, ransparenca e njësive të vetëqeverisjes vendore, Konsultimi publik në njësiti të vetëqeverisjes vendore, Këshilli Bashkiak, Seancat e këshillimeve me bashkinë/publikun, E drejta e kërkesës/ankesës, Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, Funksionet e Bashkive në fushën e shërbimeve sociale.



Aktiviteti 3: TRYEZË E RRUMBULLAKËT

Në takim morën pjesë 25 pjesëmarrës në total, ndër të cilët kishte pjesëmarrës nga Këshilli Bashk i Lezhës ku ishin prezent Kryetari i Këshillit Bashkiak, Nënkyetari i Këshillit Bashkiak dhe Sekretaria e Këshillit Bashkiak Lezhë, Këshilli Vendor Rinor pranë Bashkisë Lezhë, NJVKSH Lezhë, organizatat e shoqërisë civile në Lezhë e ekspertë nga shoqëria civile në Tiranë, aktivistë të qytetit dhe komuniteti i Lezhës.

Çështjet që janë diskutuar gjatë këtij takimi ishin:

1. Çfarë është edukimi i ligjor i publikut?
2. Raportet më të fundit lidhur me Edukimin ligjor të publikut në rang kombëtar dhe lokal:
3. STRATEGJIA PËR EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT 2019-2023
4. KOORDINATOR PËR EDUKIM LIGJOR:



Aktiviteti 3: Hartimi I Plan Veprimit Lokal (2023-2026) për Edukimin Ligjor të qytetarëve të Lezhës.

Në përbushje të objektivit të dytë të këtij projekti dhe në zbatim të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është zhvilluar një Plan Veprimi Lokal për Edukimin Ligjor të qytetarëve të Lezhës. Ky plan, i cili ka një periudhë zbatimi prej 3 vitesh, është dorëzuar tek Bashkia Lezhë, institucioni përgjegjës për implementimin e tij. Bashkia, në një përgjigje zyrtare, ka shprehur gatishmërinë e saj për të mbështetur zbatimin e planit të veprimit, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak Lezhë.

Hartimi i këtij plani lokal për edukimin ligjor në Lezhë ka si bazë Strategjinë Kombëtare të Edukimit Ligjor të Publikut, duke përcaktuar si objekt kryesor rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit. Për të arritur këtë objekt, janë identifikuar hapa dhe masa konkrete, të mbështetura në strategjinë e përmendur.

Për zhvillimin e këtij Planit Lokal të Veprimit, janë përfshirë dy ekspertë: Z. Hekuran Koka dhe Znj. Afërdita Gjoni. Këta ekspertë kanë bashkëpunuar në krijimin e këtij produkti final, i cili përcakton hapa konkrete për avancimin e shërbimit të edukimit ligjor për publikun, duke përfshirë të gjitha aktorët nga Bashkia Lezhë deri te organizatat e shoqërisë civile dhe grupet rinore, siç është Këshilli Rinor Vendor Lezhë.

Së bashku me këtë aktivitet, kemi realizuar nënshkrimin e Memorandumeve të Bashkëpunimit me aktorë të shoqërisë civile, me qëllim që të ndërmarrim iniciativë të përbashkëta në zbatim të Planit Lokal të Veprimit. Deri më tani, Memorandumet e Bashkëpunimit janë nënshkruar nga:

• Fondacioni Mary Ward Loreto, Organizata "Opportunity Balance & Overcoming", Klubi i Letrave "Ndoc Gjetja", Këshilli Vendor Rinor pranë Bashkisë Lezhë.

Ky bashkëpunim është një hap konkret drejt përfshirjes së aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile në zbatimin e Planit Lokal të Veprimit dhe në rritjen e ndërgjegjësimit ligjor në komunitetin e Lezhës. Kjo partneritet ka potencialin për të krijuar një impakt të thellë dhe të qëndrueshëm në përmirësimin e edukatës ligjore dhe mbështetjen e qytetarëve në këtë drejtim.

STAFI 2023

STAF ME KOHË TË PLOTË

1. Marjana Dedaj, Drejtuese Ekzekutive
2. Vasilika Laska, Koordinatorë e Përgjithshme & Menaxhere e Projekteve
3. Denisa Karaçi, Anëtare Bordi & Menaxhere Projekti

EKSPERT AD HOC PËR SHËRBIME TËNDRYSHME NË PROJEKTET E ZBATUARA

1. Hekuran Koka
2. Merushe Zeneli
3. Oldiana Gjini
4. Elona Capo
5. Bardhok Ndreca
6. Afërdita Gjoni
7. Romina Palushaj
8. Amarildo Laska
9. Xhorxh Baxhaku
10. Lysiena Topi
11. Arbërorë Leti



Social
Inclusion
For
Development

Statistika

1. Aktivitete total (pa përfshirë aktivitet e projekteve): 12
2. Projekte Total të Zbatuara : 3
3. Aktivitete bashkë me aktivitetet e projekteve: 25
4. Përfitues total nga aktivitete dhe projekte drejtpërdrejtë: 407
5. Përfitues të drejtëpërdrejtë bashkë me përfitues nëpërmjet fushatave online: +600.
6. Partneritete dhe Aktivitete të Përbashkëta: 8
 - Këshilli Vendor Rinor
 - Kongresi Rinor Kombëtar
 - Smart Balkans
 - Bashkia Lezhë
 - Qendra H.A.N.A
 - Albanian Skills
 - United Nations Association
 - Partners Albania

Gjithashtu "SOCIAL INCLUSION FOR DEVELOPMENT" është pjesë e:

1. Këshillit Kombëtar të Rinisë pranë Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
2. Këshillit Vendor Rinor pranë Bashkisë Lezhë

me përfaqësuese Znj.Vasilika Laska



Social
Inclusion
For
Development

Fund

“Ne besojmë në atë çfarë bëjmë”

Përgatiti: Vasilika Laska (Koordinatore e Përgjithshme)

Miratoi: Marjana Dedaj (Drejtore Ekzekutive)

Bordi Drejtues

Afërdita Gjoni

Denisa Karaçi

Rigena Jakaj

